

Plotësimi i Rregullës së X për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit

Autorizuar me Nenet 20.1(a), 22, 24, 28.1(f), 32, 33 dhe 46 të Rregullorës Nr. 1999/21 mbi Licensimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Bankave.

1. Qëllimi i Rregullës

Kjo Rregullë zbatohet për të gjitha bankat dhe institucionet financiare ashtu siq është e definuar në Rregulloren Nr. 2004/2 të cilat veprojnë në Kosovë, duke përfshirë operatorët e transferit të parave dhe zyrat e këmbimeve valutore.

Kjo Rregullë themelon kërkesat sa i përket shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit ,në lidhje me kujdesin e duhur ndaj konsumatorëve, mbajtjen dhe ruajtjen e shënimeve, monitorimin e transaksioneve, raportimin e valutave dhe transaksioneve të dyshimta, procedurat dhe politikat e brendshme, si dhe trajnimin dhe aftësimin e stafit.

2. Përgjegjësitë e Bordit Drejtues dhe Menaxhmentit

Si pjesë e rëndësishme e përgjegjësiave të gjithëmbarshme të Bordit Drejtues të bankave dhe institucioneve financiare për sa i përket drejtimit dhe menaxhimit janë:

- a) Që të miratojë politika dhe procedura efektive të shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit;
- b) Që të garantojë se politikat dhe procedurat e shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit të implementohen tërësisht në praktikë;
- c) Që të garantojë që funksioni i brendshëm i pajtueshmërisë së shpërlarjes së parave dhe pengimi i financimit të terrorizmit, si dhe auditimi i brendshëm janë të pajisura mirë teknikisht dhe të pajisura me personel që kanë njohuri të plotë të politikave dhe procedurave të shpërlarjes së parave dhe të pengimit të financimit të terrorizmit , si dhe posedojnë standarde të larta etike dhe ekspertiza përkatëse;
- d) Që të miratojë politika për themelimin dhe mirëmbajtjen e marëdhënjeve biznesore, veçanërisht atyre që janë kanë shkallë më të lartë të rrezikut, duke përfshirë personat e hapur politikisht;
- e) Që të sigurojnë Bordit Drejtues rolin e largimit të Udhëheqësit të funksionit të pajtueshmërisë së shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit, nëse rrethanat e kërkojnë një largim të tillë;
- f) Pranimi dhe diskutimi i raporteve të auditimit të brendshëm për sa i përket implementimit të politikave dhe procedurave të shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit ;
- g) Përvetësimi i masave të këtuilla, të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohe nga AQBK-ja.

Menaxhmenti i bankës dhe institucionit financiar duhet të jetë përgjegjës për të garantuar implementimin efektiv të të gjitha politikave dhe procedurave të shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit në baza të përditëshmërisë.

3. Funkzioni i brendshëm i pajtueshmërisë së shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit

Bankat dhe institucionet financiare duhet të nominojnë një apo dy individë të kualifikuar me përvojë relevante dhe përvojë përkatëse për funksionin e brendshëm të pajtueshmërisë së shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit, dhe të zgjedhin një person të caktuar si Udhëheqës i këtij funksioni, i cili do të jetë person kontaktues për qëllimet e shtruara në Paragrafin 3.16 të Rregullores 2004/2. Udhëheqësi i këtij funksioni mund të largohet nga pozita e tij vetëm me pëlqimin paraprak të Bordit Drejtues. Nëse ndodhë kjo, atëherë banka apo institucioni financiar duhet të njoftojë menjëherë AQBK-në për vendimin e tyre, duke dëshmuar bazat për largimin e tij.

Funksioni i pajtueshmërisë së shpërlarjes së parave dhe pengimi i financimit të terrorizmit, duhet që të këshillojë dhe ndihmojë Bordin Drejtues dhe menaxhmentin për implementimin e rregullave dhe rregulloreve të shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit. Ndër të tjera duhet të jetë përgjegjës:

- a) përgaditë politikat dhe procedurat e brendshme të shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit (sipas paragrafit 4 të këtij rregulli) për t'u miratuar nga Bordi Drejtues;
- b) Monitoron implementimin e politikës dhe procedurave të brendshme të shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit ;
- c) Mban lidhje me auditorët e brëndshëm dhe të jashtëm , si dhe me menaxhmentin në lidhje me çështjet e shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit ;
- d) Planifikon dhe mbikqyrë trajnimin në lidhje me shpërlarjen e parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit;
- e) Definon kriteret e marëdhënjëve të biznesit, të cilat paraqesin shkallë më të lartë të rrezikut, siç është e përshkruar në paragrafin 6 të kësaj Rregulloreje;
- f) Raporton Qendrës Integjente Financiare (QIF) në përputhje me Nenet 3.9 dhe 3.10 të Rregullores 2004/2;
- g) Përveq këtyre, ka edhe detyra tjera të cilat përcaktohen nga Bordi Drejtues ose menaxhmenti që t'i ndihmojnë bankës ose institucionit financiar në parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin për qëllime terroriste .

4. Politikat dhe procedurat e brendshme e shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit

Bankat dhe institucionet financiare duhet që të miratojnë politika dhe procedura të brendshme të shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit, dhe ti komunikojnë ato tek i gjithë stafi përkatës.

Politikat dhe procedurat e këtilla duhet që të vendosin së paku këto në vijim:

- a) procedurat për kujdesin e duhur ndaj konsumatorëve në përputhje me paragrafin 6 të këtij rregulli;
- b) procedurat për mbledhjen dhe mirëmbajtjen e informacioneve dhe shënimeve në pajtueshmëri me Rregulloren Nr. 2004/2, si për parandalimin e hyrjeve të pa autorizuara në këto informacione;
- c) procedurat për raportimin në Qendrën Intelgjente Financiare (QIF) në përputhje me Nenet 3.9-3.15 të Rregullores Nr. 2004/2;
- d) kriteret të cilat duhet të aplikohen për identifikimin e marëdhënjeve të biznesit, të cilat paraqesin shkallë më të lartë të rrezikut, siç është e definuar në paragrafin 6 të kësaj rregulle;
- e) politika për personat e hapur politikisht;
- f) procedurat për zhvillimin nga ana e bankës ose institucionit financiar në lidhje me treguesit e pastrimit të parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste;
- g) situatat në të cilën vepron funksioni i pajtueshmërisë së shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit, duhet të kosulltohet me stafin dhe rastet kur duhet të njohtohet edhe Bordi Drejtues për sa u përket ngjarjeve që kane të bëjnë me shpërlarjen e parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit ;
- h) Politika për shqyrtimin, aftësimin dhe trajnimin e stafit për qëllime të shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit .

Këto politika dhe procedura të brendshme të shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit , duhet të miratohen me anë të vendimit nga Bordi Drejtues dhe të implementohen në baza të përditëshmërisë nga menaxhmenti dhe stafi.

5. Roli i auditimit të brendshëm dhe të jashtëm

Funksioni i auditimit i brendshëm në banka dhe institucione tjera financiare duhet të bëjë kontrollë të rregullta që të garantojë se politikat dhe procedurat për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit, janë plotësisht të implementuara dhe në përputhje me kërkesat e Rregullores Nr. 2004/2, këtë Rregull dhe direktivat paraprake. Funksioni i auditimit i brendshëm duhet t'i raportojë periodikisht Bordit Drejtues së bankës ose institucionit financiar, për konkluzionet dhe vlerësimet e gjetura, duke përfshirë këtu vlerësimin adekuat të trajnimit të stafit për çështje të shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit .

AQBK-ja mund të kërkojë që bankat dhe institucionet financiare të angazhojnë auditorë të jashtëm që të vlerësojë dhe raportojë për kualitetin e implementimit të masave të shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit (duke përfshirë zbatimin e

kërkesave ligjore dhe rregullative, implementimin e politikave dhe procedurave, sistemet e brendshme të kontrollit dhe performansën e auditimit të brendshëm)

6. Kujdesi i duhur ndaj konsumatorëve

Bankat dhe institucionet financiare duhet të administrojnë në mënyrë të tërësishme kujdesin e duhur për konsumatorë, duke përfshirë:

- a) identifikimin e konsumatorëve, duke përfshirë beneficionet e pronarëve;
- b) mledhja e informacionit për konsumatorët për të krijuar profilin e tyre;
- c) aplikacionet për pranimin e politikës për konsumatorë të rinjë;
- d) mirëmbajtja e informatave të konsumatorëve në baza të vazhdueshme;
- e) monitorimi i transaksioneve të konsumatorëve; dhe
- f) implementimi i politikave të përshkuara dhe praktikave për sa i përket transferëve elektronikë dhe korespondimet bankare.

6.1 Identifikimi i konsumatorëve

Bankat dhe institucionet financiare duhet të garantojnë që ata kanë njohuri të hollësishme për identifikimin e konsumatorëve dhe për bizneset e konsumatorëve para se të hyjnë në marrëdhënje biznesore, duke u bazuar në obligimet e paragrafeve 3.1-3.7 të Rregullores së plotësuar Nr. 2004/2, dhe posaqërisht identifikimi i dokumentacionit që është specifikuar në paragrafet 3.3-3.4 të asaj Rregulloreje.

Bankat dhe institucionet financiare duhet të ndërmarrin hapa plotësues për të garantuar identifikimin e saktë të konsumatorëve, kur paraqiten dyshimet për sa i përket saktësisë dhe korrektësitë së të dhënave të mbledhura dhe të identifikuara më parë, apo kur ekziston dyshimi që konsumatori është i involvuar në shpërlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit.

Në rast se bankat dhe institucionet financiare ushtrojnë biznes apo ekzekutojnë transaksione me konsumator, i cili nuk është prezent fizikisht për qëllime të identifikimit, bankat dhe institucionet financiare duhet të marrin masa shtesë për të adresuar rrezikun specifik të shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit.

Masat shtesë për bizneset që nuk janë prezente fizikisht, mund të përfshijnë:

- a) verifikimin e dokumentacionit;
- b) kërkesa me shkrim për dokumentacion plotësues, si është fatura e shërbimeve publike;
- c) zhvillimi i mjeteve tjera për sa i përket kontaktimit me konsumatorë.

6.2 Përcaktimi i pronarëve përfitues

Bankat dhe institucionet financiare duhet që të ndërmarrin masa për të përcaktuar nëse konsumatori vepron në emër të një apo më shumë pronarëve përfitues në përputhje në paragrafet 3.9-3.15 të Rregullores Nr. 2004/2. Nëse është ashtu, banka dhe institucioni financiar duhet ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të verifikuar identitetin e pronarit përfitues duke përdorur informacione paraprake, apo të dhëna të mbledhura nga burimet e besueshme, në mënyrë që banka apo institucioni financiar të jetë i kënaqur që e njëj identitetin e pronarit përfitues.

Për konsumatorët të cilët janë entitete, siç janë definuar në Rregulloren Nr. 2004/2, banka apo institucioni financiar duhet ndërmarrë masa të arsyeshme për të kuptuar pronësinë dhe kontrollojë strukturën e entitetit. Kjo përfshinë identifikimin natyral të individit-individëve të cilët përfundimisht kontrollojnë entitetin.

Për entitetet të cilat janë organizata jo profitabile (si klubet, shoqatat, dhe organizatat bëmirëse) banka apo institucioni financiar duhet të siguroj vehten për qëllime legjimitive të organizatës, duke përfshirë rishikimin e statusit të tij, dekretit, ose instrumentet e besueshmërisë .

Pronari përfitues e ka kuptimin e individit natyral, i cili përfundimisht është pronar apo kontrollon konsumatorin, pra individi në emër të të cilit përcillet (drejtohet) transaksioni. Kjo përfshinë individin i cili ushtron kontrollë efikase përfundimtare mbi entitetin.

6.3 Rritja e kujdesit të duhur ndaj konsumatorëve me shkallë të rrezikut të lartë, Marëdhënjet e Biznesit, dhe Transaksionet

Bankat dhe institucionet financiare duhet të aplikojnë rritjen e kujdesit të duhur ndaj konsumatorëve, marëdhënjet e biznesit, dhe transaksionet të cilat mund t'i ekspozohen një rreziku më të lartë për sa i përket pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Marëdhënjet e biznesit për personat e hapur politikisht (PHP) duhet gjithmonë të mendohet se mund të involvojnë një shkallë më të lartë të rrezikut.

Rritja e kujdesit të duhur ndaj konsumatorëve duhet të aplikohet në çdo nivel për kujdesin e duhur ndaj konsumatorëve, marëdhënjet e biznesit , dhe transaksionet që banka apo institucioni financiar i ka përcaktuar se janë me rrezik më të lartë për sa i përket pastrimit të parave dhe financimin të veprimtarive terroriste.Kjo do të përfshijë vështrimin hetues për burimin e pasurisë si dhe burimin e fondeve të konsumatorit.

Bankat dhe institucionet financiare nuk duhet të hyjnë apo mbajnë një marëdhënie biznesore me konsumatorët të cilët paraqesin një rrezik më të lartë të konsumatorit, përderisa të është bërë miratimi me shkrim nga ana e anëtarit të lartë ose menaxhmentit të bankës apo institucionit financiar.

6.4. Krijimi i profilit të konsumatorit

Bankat dhe institucionet financiare duhet të mbledhin informata për sa i përket qëllimit të parashikuar dhe natyrën e vertetë të marëdhënjes së biznesit.

Bankat dhe institucionet financiare duhet të krijojnë dhe mirëmbajnë profilin për secilin konsumatorë, duke përfshirë këtu natyrën dhe detajet e mjaftueshme në mënyrë që t'i ndihmojë bankës apo institucionit financiar për ta bërë monitorimin e transaksioneve të konsumatorit, aplikojë ngritjen e kujdesit të duhur ndaj konsumatorëve aty ku është e domosdoshme, dhe të zbulojë transaksione e dyshimta, siç kërkohet në paragrafin 3 të Rregullores Nr. 2004/2 dhe këtij Rregulli. Niveli i detajeve të cilat përfshihen në profil duhet të jetë në përputhje me nivelin e rrezikut të pritur nga ana e konsumatorit.

Profili i konsumatorit duhet të përmbajë informacione paraprake për sa i përket veprimtarisë normale dhe të arsyeshme për konsumator të veçantë, duke marrë parasysh natyrën e biznesit të konsumatorit, si dhe të kuptuarit të hollësishëm të transaksioneve të konsumatorit (duke përfshirë ashtu siq është e nevojshme burimin dhe legjimitetin e fondeve) si dhe marëdhënjet e përgjithshme me bankat apo me institucionin financiar.

6.5 Pranimi i konsumatorëve të rinjë

Në rastet kur bankat apo institucionet financiare nuk janë në gjendje të verifikojnë identitetin e konsumatorit në përputhje në paragrafin 3.7 të Rregullores Nr. 2004/2, banka apo institucioni financiar duhet që të refuzojë transaksionin dhe të regjistrojë në dosje raportin për transaksionin e dyshimtë, siç kërkohet në paragrafin 3.9 të Rregullores Nr. 2004/2.

Procedurat, politikat dhe kontrollat për pranimin e konsumatorëve të rinjë nuk duhet të jenë aq përkufizuese në mënyrë që të ndikojnë në mohimin e hyrjes së anëtarëve nga publiku i gjërë në shërbime financiare, veçanërisht për personat të cilët nuk janë të avancuar në aspektin financiar ose shoqëror.

6.6 Mirëmbajtja e informacioneve për konsumatorë në baza të vazhdueshme

Bankat ose institucionet financiare duhet të mbledhin dhe mirëmbajnë informacionet për konsumatorë në bazë të vazhdueshme. Dokumentacioni, të dhënat e mbledhura duke u bazuar në kujdesin e duhur ndaj konsumatorëve duhet të mbahen të freskëta duke i ndërmarrë shqyrtime periodike të shënimeve ekzistuese, duke përfshirë edhe shënimet për transaksione.

6.7 Përfundimi i marëdhënies me konsumatorët

Nëse banka apo institucioni financiar nuk është në gjendje t'i përgjigjet kërkesës për kujdesin e duhur ndaj konsumatorit, atëherë duhet të përfundojë marëdhënjen me konsumatorin dhe të përcaktojë nëse duhet të regjistrojë në dosje raportin e transaksionit të dyshimtë, siç është e paraqitur paragrafin 3.9 të Rregullores Nr. 2004/2.

7. Monitorimi i marrëdhënieve biznesore dhe transaksioneve

Bankat apo institucionet financiare duhet të drejtojnë (udhëheqin) vazhdimisht kujdesin e duhur ndaj marrëdhënjëve biznesore dhe të vëzhgojnë transaksionet e ndërmarra gjatë procesit të marrëveshjes, që të sigurojnë se transaksionet e ekzekutuara janë në përputhje me dijeninë e institucionit për konsumatorin, biznesin e tij dhe profilin e rrezikut . Për këtë qëllim, aty ku është e nevojshme informacioni duhet të njihet për të konfirmuar burimin e fondit. Bankat dhe institucionet financiare duhet të kenë një sistem të vendosur që të hetojnë kur bëhen transaksionet e mëdha jashtë normave të pritura për atë lloj konsumatori.

Bankat dhe institucionet financiare duhet të aplikojnë monitorim të intensifikuar për konsumatorët të cilët paraqesin një rrezik më të lartë. Çdo bankë dhe institucion financiar duhet të caktojë treguesit kryesor për llogari të tilla, duke marrë shënime për historinë e konsumatorit, si vendi dhe origjina dhe burimi i fondeve, llojin e transaksionit të involvuar, dhe faktorët tjerë të rrezikut, siç janë dhënë në paragrafin 6 të kësaj Rregulle.

8. Mbajtja e të dhënave dhe Ruajtja e tyre

Bankat dhe institucionet financiare duhet t'i ruajnë të gjitha të dhënat (shënimet) e nevojshme për transaksione, për ato vendore dhe ndërkombëtare, së paku 5 vjet që nga data kur është bërë transaksioni (apo më gjatë nëse kërkohet nga AQBK, Qendra Intelgjente Financiare (QIF), apo çdo organi kompetent në raste të veçanta). Kjo kërkesë zbatohet pa marrë parasysh se a është duke vepruar merrëveshja e biznesit apo ajo ka përfunduar.

Të dhënat për transaksione duhet të jenë të mjaftueshme për të lejuar rikonstruimin e transaksioneve individuale, dhe të ofrojë, dhe nëse është e domosdoshme, dëshmi për veprimtari kriminale. Komponentët e domosdoshme të të dhënave për transaksione përfshijnë:

- a) emri i konsumatorit dhe pronarit beneficues (mbajtja e autoritetit si avokat, nëse është e aplikueshme), adresat e tyre apo informacione tjera identifikuese, që zakonisht shënohen nga bankat apo institucionet financiare;
- b) natyra dhe data e transaksionit;
- c) lloji dhe sasia e valutës së involvuar; dhe
- d) loji dhe numri identifikues i çdo llogarije që është e involvuar në transaksion.

Bankat dhe institucionet financiare duhet t'i ruajnë të gjitha të dhënat (shënimet) e nevojshme të cilat kanë të bëjnë me konsumatorin, pronarin përfitues, ose avokatin, dosjet e llogarive, dhe korrespondenca e biznesit së paku në periudhe kohore prej pesë vitesh duke filluar nga përfundimi i marrëdhënies biznesore, apo në raste specifike edhe më gjatë nëse kërkohet nga AQBK, Qendra Intelgjente Financiare (QIF), apo ndonjë organi tjetër kompetent. Të dhënat duhet të identifikojnë anëtarin e stafit, i cili e ka bërë identifikimin e konsumatorit (pronarin përfitues, aty ku është e aplikueshme).

Bankat dhe institucionet financiare duhet të themelojnë mjete sigurimi për t'i mbrojtur shënimet nga dëmtimi dhe që parandalojnë hyrjet e pautorizuara.

Bankat dhe institucionet financiare duhet t'i kenë të gatshme sipas kërkesës së AQBK-së, Qendrës Intelgjente Financiare (QIF), apo të ndonjë organi tjetër kompetent, të gjitha informacionet e duhura për konsumatorin, proanrin beneficues, avokatin si mbajtës së autoritetit dhe të gjitha të shënimet e kërkuara për transaksione, në mënyrë dhe formë të hollësishme, me kohë dhe të kuptueshme.

Aty ku banka dhe institucioni financiar është i vetëdijshëm që të dhënat në lidhje me hetimet e vazhdueshme, ku të dhënat e tilla duhet të ruhen deri sa të konfirmohet nga ana e ndonjë gjykate kompetente se rasti është mbyllur.

9. Identifikimi i veprimtarive të dyshimta dhe transaksioneve

Bankat dhe institucionet financiare duhet të ofrojnë udhëzime dhe trajnime të mjaftueshme stafit në mënyrë që t'u mundësojë atyre që të identifikojnë aktet dhe transaksionet e dyshimta .

Bankat dhe institucionet financiare duhet të sigurojnë që të gjithë punonjësit duhet të dijnë se cilit person brenda bankës ose institucionit financiar apo anëtarit të stafit duhet që t'i raportojnë për ndonjë dyshim dhe që ekziston një zinxhir i qartë i raportimit sipas së cilit këto dyshime do të barten tek nëpunësi i pajtueshmërisë së shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit .Vija e raportimit në mes të personit i cili dyshon dhe të nëpunësit të pajtueshmërisë së shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit, duhet të jetë sa më e shkurtër që është e mundur.

Kur nëpunësit e pajtueshmërisë së shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit e pranojnë raportin fillestar, atëherë duhet që të kontrollojmë dhe analizojmë rastin. Bankat dhe institucionet financiare duhet t'i ruajnë të gjitha të dhënat për sa u përket analizave dhe rezultateve të tilla. Nëse, gjatë rishikimit të analizave dhe rezultateve, banka apo institucioni financiar konkludon se aktet ose transaksionet ofrojnë pikëpamje të arsyeshme të dyshimit për pastrimin e parave, ose për ndonjë lidhje në financimin për veprimtaritë terroriste, atëherë nëpunësit e pajtueshmërisë së shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit, duhet të raportojnë saktë veprimtarinë ose transaksionin tek Qendra Intelgjente Financiare (QIF). Të gjitha kërkesat e brendshme të cilat bëhen në lidhje me raportin, dhe bazën se a të dërgohet apo jo ai raport në Qendrën Intelgjente Financiare (QIF), duhet të dokumentohen. Shënimet për dyshimet e ngritura në mënyrë interne nga nëpunësit e pajtueshmërisë së shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit, por që nuk janë dërguar tek Qendra Intelgjente Financiare (QIF), duhet të ruhen për pesë vite duke filluar nga dita kur është bërë transaksioni. Të shënimet për dyshimet e raportuara të cilat ndihmojnë hetuesinë duhet të ruhen gjersa banka apo institucioni financiar të informohet nga gjykata përkatëse që të dhënat e tilla nuk janë më të nevojshme.

10. Raportimi i veprimtarive dhe transakcioeneve të dyshimta dhe transakcioneve me para të gatshme që tejkalojnë shumën prej 10,000 Euro

Paragrafi 3.9 i Rregullores Nr. 2004/2 kërkon raportimin në Qendrën Intelgjente Financiare (QIF) për veprimtaritë dhe transakcionet e dyshimta dhe transakcionet me para të gatshme që tejkalojnë shumën prej 10,000 Euro.

Informacione të mjaftueshme duhen që të zbulohen për sa i përket natyrës dhe arsyes për së dyshimit, dhe poashtu duhet cekur nëse dyshohet për ndonjë kundërvajtje të veçantë. Aty, ku bankat apo institucionet financiare kanë dëshmi përkatëse plotësuese, e cila mund të jetë në disponim, atëherë natyra e kësaj dëshmie duhet të tregohet qartë në rast të raportimit në Qendrën Intelgjente Financiare (QIF), dhe kjo duhet të bëhet pa u vonuar në QIF.

Nëse banka apo institucioni financiar vendos që të mos hyjë në marrëdhënje biznesore për shkak të dyshimit të shpërlarjes së parave, ose të financimit të veprimtarisë terroriste, atëherë, menjëherë duhet lajmëruar Qendrën Intelgjente Financiare (QIF)

Bankat dhe institucionet financiare duhet të raportojnë Qendrën Intelgjente Financiare (QIF), për çdo konsumator ose transakcion nëse kanë të dhëna të arsyeshme për të dyshuar se kanë ndonjë lidhje në financimin e veprimtarive terroriste apo të individëve të cilët e përkrahin terrorizmin. Duhet kushtuar kujdes të veçantë monitorimit dhe mbajtjes së listës së fundit të organizatave dhe individëve të cilët kanë lidhje me terroristë apo terrorizëm, duke u bazuar në informacionin e marrë nga Qendra Intelgjente Financiare (QIF), apo nga burimet tjera të mundshme. Poashtu, duhet kushtuar kujdes organizatave jo profitabile dhe atyre humanitare, veçanërisht nëse këto veprimtari nuk janë në pajtueshmëri me veprimtarinë e regjistruara, nëse burimi i fondeve nuk është i qartë, apo nëse këto organizata kanë pranuar mjete nga burime të dyshimta.

11. Informacioni për Iniciatorin

Bankat dhe institucionet financiare duhet të marrin dhe mirëmbajnë informacione të plota për inicuesin e të gjitha transferëve elektronike dhe t'i verifikojnë që informacioni është i saktë dhe kuptimplotë.

Informacioni i plotë për inicuesin përmbanë:

- a) emri i inicuesit;
- b) numrin e llogarisë së inicuesit, apo numrin unik të references nëse nuk ka numër të llogarisë; dhe
- c) numrin zyrtar identifikues të inicuesit, apo numrat tjerë identifikues, datën dhe vendin e lindjes, si dhe adresa.

Bankat dhe institucionet financiare duhet të përfshijnë informacione të plota të inicuesit në forma të porosisë apo pagesës për transferin e bërë, dhe kur ata veprojnë si

ndërmjetësues në zingjirin e pagesave, ata duhet të marrin edhe informacione të plota për inicuesin e transferit dhe të transmetojnë atë.

Në rast të transferëve vendorë dhe elektronike, mjafton që banka apo institucioni financiar urdhërues duhet që të përfshijë vetëm numrin e llogarisë së inicuesit, ose nëse nuk ka numër të llogarisë, atëherë identifikimi unik, brenda formularit të mesazhit apo pagesës, të cilat japin informacione të plota për inicuesin dhe mund të jenë në dispozicion për bankën përfituese apo institucioni financiar përfitues, si dhe për AQBK-në apo Qendrën Intelgjente Financiare (QIF) brenda tri ditëve të punës, duke filluar nga dita e marrjes së kërkesës.

Banka përfituese apo institucioni financiar përfitues duhet të identifikojë dhe shqyrtojë me kujdes transferin elektronik, i cili nuk shoqërohet më informacionin e plotë për inicuesin. Ata duhet që të ndërmarrin masa që të verifikojnë informacionin që mungon nga banka urdhëruese, institucioni financiar apo nga përfituesi. Nëse ata nuk sigurojnë informacionin që mungon, ata duhet refuzojnë pranimin e transferit dhe të raportojnë tek Qendra Intelgjente Financiare (QIF).

12. Bankat Koresponduese jashtë kufirit dhe marëdhënjet e ngjajshme

Bankat duhet të zhvillojnë dhe inplementojnë politika dhe procedura në lidhje me bankat koresponduese.

Banka duhet të ushtrojë maturi dhe kujdes të duhur për sa i përket kontrollës së bankave koresponduese për pastrimin e parave dhe financimin e veprimtarive terroriste, si dhe të përcaktojë që kontrollat e tilla janë adekuate dhe efikase, dhe duhet të dokumentojë përgjegjësitë e secilit institucion për shpërlarjen e parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit.

Banka duhet të zhvillojë dhe implementojë politikat dhe procedurat për sa i përket veprimtarisë së monitorimit të aktiviteteve të cilat zhvillohen nëpërmjet llogarive koresponduese. Banka duhet të sigurojë aprovim nga menaxhmenti i lartë para se të krijojë marëdhënje të reja koresponduese.

13. Kërkesat plotësuese për Zyrat e Këmbimit të Valutave të Huaja dhe Operatorët e Transferit të Parave

Zyrët e Këmbimit të Valutave të Huaja dhe Operatorët e Transferit të Parave duhet të jenë në pajtueshmëri me parimet e rregullës së shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit.

Zyrët e Këmbimit të Valutave të Huaja dhe Operatorët e Transferit të parave duhet të zhvillojnë dhe implementojnë procedurat në mënyrë që t'i kushtojnë kujdes të veçantë transakcioneve të shumëfishta të valutave të cilat janë kryer në emër të një personi apo një entiteti dhe që shuma totale arrin më shumë se 10,000 Euro brenda ditës, ose seritë të

transaksioneve për një periudhë të shkurtër kohore. Kur të ekzekutohen transaksionet e shumëfishta të valutave në filiala të ndryshme të Zyrate të Këmbimit të Valutave të Huaja dhe Operatorëve të Transferit të Parave, atëherë ato duhet që të trajtohen si transaksion i vetëm .

Procedurat duhet të garantojnë se sa më shpejtë që bëhet e qartë për Zyrat e Këmbimit të Valutave të Huaja dhe Operatorët e Transferit të Parave për konsumatorin që ekzekuton transaksione nën shumën prej 10,000 Euro në lokacione të ndryshme brenda ditës, atëherë ai konsumator duhet të identifikohet dhe raportohet tek Qendra Intelgjente Financiare.

Operatorët e Transferit të Parave duhet të garantojnë identifikimin e konsumatorit (personi i thjeshtë apo legal) për sa i përket pagesës dhe pranimi të fondeve.

14. Verifikimi, Aftësimi dhe Trajnimi i Stafit

Efikasiteti i procedurave dhe rekomandimeve që janë përfshirë në këtë Rregull varet nga niveli në të cilin stafi i bankave dhe institucioneve financiare e vlerëson natyrën serioze të pastrimit të parave, ose të financimit të veprimtarive terroriste. Bankat dhe institucionet financiare duhet t'i bëjnë me dije stafit për obligimet e tyre statusore, dhe të informojë ata se mund të kenë përgjegjësi personale nëse dështojnë që të raportojnë informatat në pajtueshmëri me politikën dhe procedurat e brendshme.

Bankat dhe institucionet financiare duhet të paraqesin masa të hollësishme për të garantuar që punonjësit e tyre, veçanërisht stafi i cili ka kontakt me konsumatorët ose që ekzekutojnë transaksione, si dhe stafi zyrtar i shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit, se nuk kanë shënime kriminale ose nuk janë subjekte të akuzimit për veprimtari kriminale dhe krime financiare, terrorizëm, ose krime serioze të cilat mund të vëjnë në dyshim besueshmërinë ndaj tyre.

Bankat dhe institucionet financiare duhet të ofrojnë trajnim të përhershëm për tërë stafin përkatës për sa i përket parandalimit të shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit. Stafi i ri duhet të përcjellë trajnimin e shpërlarjes së parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit, para se të angazhohet në marrëdhënje biznesore me konsumatorë apo në ekzekutimin e transaksioneve financiare.

Punonjësit duhet të jenë të vetëdijshëm për politikën dhe procedurave e brendshme, të cilat duhet të respektohen për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit, të cilat janë kërkesa ligjore të përfshira në Rregulloren Nr. 2004/2 dhe në këtë Rregull, veçanërisht për sa i përket lidhshmërisë për njohjen, monitorimin dhe raportimin e veprimtarive dhe transaksioneve të dyshimta. I tërë stafi i cili ka të bëjë me konsumatorë ose që ekzekutojnë transaksione duhet të trajnohet rregullisht, së paku njëherë në vit, me metodat e tanishme dhe llojeve të shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Po ashtu duhet të mirret në konsiderim dokumentacioni përkatës i publikuar ose i përhapur nga QIF dhe AQBK-ja.

Edhe pse, drejtorët dhe menaxhmenti i lartë mund të mos jenë të involvuar në procedurat e përditshme, është më e rëndësishme që ata i kuptojnë detyrat statusore të cilat iu janë dhënë atyre, si dhe stafit dhe vetë biznesin. Prandaj, ata duhet të marrin pjesë në trajnime, paraprakisht nga funksioni i tyre. Ky trajnim, poashtu duhet të mbulojë sanksionet e mundshme të cilat dalin nga ligjet dhe rregulloret.

Dokumentacioni i strukturës së programit të trajnimit, përmbajtja e tyre, emrat dhe nënshkrimet e pjesëmarrësve duhet të mbahen në dosje të bankës apo institucionit financiar së paku për periudhën kohore pesë vjeçare.

15. Implementimi i Rregullës

15.1. Data efektive dhe implementimi i masave

Bordi Drejtues i Autoritetit Qendror Bankar i Kosovës e ka miratuar këtë Rregullë me 4 Prill, 2007. Me këtë lëshimet e mëparshme të kësaj rregulle shfuqizohen.

Bankat dhe institucionet financiare duhet të implementojnë kërkesat e kësaj Rregulle brenda [gjashhtë] muajve kur kjo Rregullë hyn në fuqi.

Bankat dhe institucionet financiare duhet të dërgojnë një plan veprimi (duke përfshirë orarin) për të implementuar këtë Rregullë të AQBK-së me datën 15 Korrik 2007.

15.2 Zbatimi i Rregullës X për konsumatorët ekzistues

Për të gjithë marëdhënjet ekzistuese me konsumatorë, duke filluar nga dita kur Rregullë hyn në fuqi, atëherë bankat dhe institucionet financiare do të aplikojnë kujdes të duhur ndaj konsumatorëve, siç është dhënë në Paragrafin 6 nga data 30 Prill, 2007.

15.3 Direktivat Administrative dhe Udhëzimet e Qendrës Intelgjente Financiare

Nëse në rastet kur Qendra Intelgjente Financiare lëshon ndonjë direktivë ose udhëzim që nuk është në pajtim me dispozitat e kësaj rregulle, atëherë lëshimet e QIF do të zëvendësojnë atë dispozitë.